

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Tregjet dhe institucionet financiare
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Salla D1
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Mejdi Bektashi
Detajet kontaktuese:	mejdi.bektashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda fokusohet kryesisht në rolin e tregjeve financiare dhe institucioneve financiare në ekonomi. Ai synon t'u japë studentëve të kuptuarit për llojet e ndryshme të tregjeve dhe institucioneve financiare, instrumentet financiare, funksionimin e tregjeve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, bashkëveprimet ndërmjet pjesëmarrësve kryesor të tregut, mjedisin rregullativ dhe institucional në të cilin ata veprojnë.</p> <p>Kjo lëndë studion lloje të shumta të instrumenteve financiare, të tilla si aksione dhe obligacione, dhe instrumente moderne financiare të tilla si instrumentet derivative (opcionet, kontratat fjuçers, swaps kontratat etj). Lënda gjithashtu shtjellon forma të ndryshme të institucioneve financiare, ndërmjetësve financiarë (banka dhe jo-banka). Kursi elaboron edhe segmentet e tregut financiar, si tregun e parasë, kapitalit dhe tregun e valutës.</p> <p>Gjithashtu mbulon trajtime të veçanta në lidhje me konceptin e rrezikut, menaxhimin të rrezikut në institucionet financiare, kryesisht rreziku kreditor dhe i tregut.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës është që të elaborojë kuptimin e sistemit financiar, dhe që të ofrojë njohuri për studentët në lidhje me mekanizmat, strukturën dhe praktikën e aktiviteteve të sistemit financiar modern, tregjet financiare dhe institucionet financiare.</p> <p>Studentët do të jenë në gjendje për të kuptuar teorinë, njohuritë themelore dhe teknikat e përdorura në sektorin financiar, për të kuptuar ngjarjet e rëndësishme financiare dhe marrjen e vendimeve financiare.</p>

	<p>Lënda përpunon aspektet e ndryshme të analizimit të natyrës, parimeve dhe teknikave të financimit bankar, financimit të ndërmjetësve tjerë financiarë, tregjeve të parasë, tregjeve të kapitalit, tregjeve të valutës dhe tregjeve të derivateve. Kursi do të ofrojë analiza të praktikave aktuale të financimit të përdorura nga shumica e vendeve të zhvilluara të BE-së, vendet e rajonit dhe Kosovës. Kursi elaboron edhe sisteme të tjera financiare të tregut të tilla si sistemi financiar islam.</p> <p>Lënda ka për qëllim t'u japë studentëve një kuptim të rolit dhe rëndësisë së parasë, kreditit, tregjeve dhe institucioneve financiare në një ekonomi moderne. Objektivi i përgjithshëm i lëndës është t'u japë studentëve një kuptim të plotë të rolit qendror të institucioneve financiare në ekonomi, veçanërisht duke theksuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rolin e sistemit financiar në ekonomi • Rolin dhe funksionin e tregjeve financiare të organizuara dhe institucioneve financiare • Funksionet dhe misionet e institucioneve financiare dhe tregjeve • Ndryshimet strukturore dhe konkurrencën në sektorin financiar 		
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti duhet të ketë njohuri dhe aftësi për të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptuar rolin e sistemit financiar në ekonomi • Kuptuar rolin e dhe funksionin e tregjeve financiare të organizuara dhe institucioneve financiare • Një familjaritet me instrumentet financiare, tregjet financiare dhe institucionet financiare • Të përshkruar rolin e institucionit financiar brenda tregjeve financiare. • Njohur tregjet më të njohura të parave dhe letrave me vlerë të tregut të kapitaleve. • Shpjeguar se si tregjet e parave përdoren nga ana e investitorëve institucionalë. • Shpjeguar se si tregjet e obligacioneve përdoren nga ana e investitorëve institucionalë. 		
<p>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</p>			
<p>Aktiviteti</p>	<p>Orë</p>	<p>Ditë/javë</p>	<p>Gjithësej</p>
<p>Ligjërata</p>	<p>3</p>	<p>15</p>	<p>45</p>
<p>Ushtrime teorike/laboratorike</p>			
<p>Punë praktike</p>			

Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	1.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	15	75
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			188.5 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Pas një ligjërate hyrëse prej tre orësh, mësimi i lëndës do të bëhet me anë të një serie javore të ligjëratave nga dy orë të përcjella me nga një orë për prezantime seminarike. Një listë e materialeve të leximit dhe të pyetjeve për seminare do të shpërndahet që më parë dhe studentët do të pritët të përgatisin përgjigje për diskutim në seminare.</i>		
Metodat e vlerësimit:	<p>20%: Pjesëmarrja në diskutimet në klasë.</p> <p>20%: Gjatë semestrit, ne do të mbulojmë disa grupe të problemeve. Secili student do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e një problemi të vendosur gjatë semestrit. Studenti do të shkruajë një punim tre-deri në pesë-faqesh (me hapësirë të dyfishtë mes rreshtave, shkronja 12-pikëshe Times New Roman, margjina e faqes 1 ") duke analizuar problemet.</p> <p>Studenti do të ketë 10-15 minuta gjatë orës për t'ia shpjeguar klasës problemin dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve. Kjo detyrë do të përfaqësojë 20% të notës së secilit nxënës.</p> <p>60%: provimi.</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Frederic S. Mishkin & Stanley G. Wakens: Tregjet dhe institucionet financiare, Person, 2003 (një pjesë e këtij libri është përkthyer në gjuhën shqipe); 2. Roger LeRoy Miller, David D. VanHoose: Paraja dhe bankat moderne (botimi i tretë) 1993; 3. Kidwell. D. S.: Institucionet financiare, tregjet dhe paratë, Willey, N.Y. 2006; 4. Bernard J. Foley: Tregjet kapitale, Macmillan Education LTD London, 1991; 		

	<p>5. <i>Frederic S. Mishkin: Ekonomia e parave, bankave, dhe tregjeve financiare botimi i 8, Pearson Education Inc. 2007;</i></p> <p>6. <i>Zamir Iqbal & Abbas Mirakhor: Hyrje në financat islame, teoria dhe praktika, John Wiley & Sons (Asia) Pte Ltd, 2007;</i></p>
Literatura shtesë:	<p>1. <i>David S. Kidwell, David W. Blackwell, David A. Whidbee, Richard L. Peterson: Institucionet financiare, tregjet dhe paratë</i></p> <p>2. <i>Stephen Cecchetti, Kemit Schoenholtz: Paratë, bankat dhe tregjet financiare</i></p> <p>3. <i>Linda Allen: Tregjet kapitale dhe institucionet: një pikëpamje globale</i></p> <p><i>Revistat dhe materialet tjera</i> www.qw.com/mishkineakins (student resources); www.federalreserve.gov www.forecasts.org/data/index.htm www.quicken.com www.nymex.com</p>
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Sistemi financiar; financimi direkt dhe ndërmjetësimi financiar; oferta dhe kërkesa në tregun financiar; rregullimi i sistemit financiar; institucionet rregullative dhe të mbikëqyrjes.
Java e dytë:	Kuptimi dhe struktura e institucioneve financiare; Banka Qendrore; karakteristikat dhe funksionet;
Java e tretë:	Institucionet depozituese dhe jodepozituese; institucionet monetare dhe jomonetare; bankat dhe institucionet financiare jobankare.
Java e katërt:	Institucionet financiare jobankare; fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimit; fondet investive; bankat kooperative; institucionet financiare të specializuara publike.
Java e pestë:	Tregjet financiare, kuptimi, struktura dhe funksionet ekonomike; tregu primar dhe sekondar
Java e gjashtë:	Tregu i parave, pjesëmarrësit në tregun e parave, letrat me vlerë të tregut të parave, fondet e investimit dhe tregjet e parave.
Java e shtatë:	Tregjet kapitale: Funkzioni dhe qëllimi; pjesëmarrësit në tregun e kapitalit; aktivitetet e tregtimit në tregun e kapitalit, letrat me vlerë të tregut të kapitalit, llojet e obligacioneve, paqëndrueshmëria/volatiliteti i tregut të obligacioneve, si të lexohen lajmet/informatat në tregun financiar.
Java e tetë:	Tregu i letrave me vlerë, llogaritja e çmimit të aksioneve të zakonshme. Si vendosen çmimet në tregun e aksioneve?

	Problemet që përcaktojnë emetimin dhe rrezikun në tregun e aksioneve; problemet në parashikimin e dividendës.
Java e nëntë:	Bankat dhe menaxhimi i bankave; ndryshimet moderne në sistemin bankar: shkaqet dhe pasojat e këtyre ndryshimeve, teknologjia informative, globalizimi, integrimi i tregjeve financiare, sigurimi i depozitave dhe roli i shtetit në tregjet financiare.
Java e dhjetë:	Llojet e monopoleve, Shoqëritë aksionare, Lidhjet monopolistike, Format e ulëta dhe të larta të lidhjeve monopolistike, Format e monopoleve sipas numrit të pjesëmarrësve, Monopolet dhe konkurrenca. (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq. 159-167)
Java e njëmbëdhjetë:	Sistemi financiar i Kosovës, karakteristikat, struktura dhe zhvillimi i sektorit financiar, institucionet financiare bankare dhe jobankare. Analiza krahasuese me shtetet e EJL.
Java e dymbëdhjetë:	Kompanitë e sigurimit dhe fondet pensionale, bankat investive, brokerët dhe ndërmjetësit tjerë financiar.
Java e trembëdhjetë:	Menaxhimi i institucioneve financiare; menaxhimi i rrezikut kreditor; menaxhimi i rrezikut të normës së interesit; instrumentet e hegjngut (mbrojtja nga rreziqet), kontratat fjuçers dhe forward.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vonesa në ligjerata dhe ushtrime; • Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme); • Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimi; • Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale. <p>Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kopjimi gjatë provimit ose testit; • Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit; • Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit; • Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsytuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.